

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-46/07-07

Prishtinë, më 16 mars 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 83 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 22 shkurtit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor,
6. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë,
7. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave,
8. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e gjyqtarëve dhe
9. Shqyrtimi i Propozimprogramit të punës së Kuvendit për vitin 2007 dhe të kalendarit vjetor.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, Grupi Parlamentar i LDK-së ka parashtruar një mocion me shkrim që në seancën e sotme të shqyrtohet edhe propozimi i Qeverisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar i LDK-së, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi propozimin për shqyrtimin e Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar i LDK-së që në seancën e sotme të shqyrtohet edhe Propozimvendimi i Qeverisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Teuta Sahatqija, kryetare e Grupit Parlamentar të ORA-s, shprehu pakënaqësi për sekretarinë e Kuvendit, sepse nuk ua kishte shpërndarë deputetëve të Kuvendit një material të dorëzuar nga OJQ-ja "Çohu". Ajo kërkoi që kjo çështje të shqyrtohet në seancën e sotme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetares së Grupit Parlamentar të ORA-s.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e kryetares së Grupit Parlamentar të ORA-s.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kolçaku** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet edhe për çështjen e vaksinave që janë ndalur në kufi. Dogana nuk i lejon vaksinat të hujnë pa u doganuar, kurse Qeveria nuk ka ndarë mjete për doganimin e tyre.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështet kërkesën e deputetës Mulhaxha, por para se kjo çështje të shqyrtohet në Kuvend, Ministria e Shëndetësisë duhet të përgatitë një informatë me shkrim lidhur me të.

Deputeti **Gani Koci** kërkoi që seancën e sotme të mos e drejtojë kryetari i Kuvendit, z. Kolë Berisha.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e deputetit Koci.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e deputetit Koci.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 22 shkurtit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 22 shkurtit 2007 u miratua pa vërejtje.